



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA TREGTARE "DENISA" SHPK
TIRANE

VENDIM NR. 2 , DATE 09.07.2007

I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE TREGTARE "DENISA" SHPK

Ne Tirane, sot ne daten 09.07.2007, Ortaku i Vetem i Shoqerise "DENISA" Shpk, ne seline e shoqerise mori ne shqyrtim rendin e dites:

- Shqyrtimi i Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar per Zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise me Kontributet ne Natyre dhe Rezervat e Fitimet e Pashperndara, te dates 08.07.2007 te pergatitur nga Z.Lavdimir Fusha, Ekspert Kontabel i Autorizuar.

Ortaku i Vetem i Shoqerise pasi u njoh me rendin e dites;

VEREN SE


Shoqeria tregtare "DENISA" Shpk, eshte regjistruar prane Zyres se Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 34084, dt. 03.10.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me Ortak te Vetem dhe Administrator Znj.Mimoza ÇOBO.

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie eshte 100.000 (njqind mije) Leke. Ky kapital eshte i barabarte me 100 (njqind) kuota, ku secila kuote ka vleren 1000 (nje mije) Leke.

Me Vendimin Nr. 01, dt. 26.06, 2007, Ortaku i Vetem i shoqerise ka vendosur:

- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise tregtare "DENISA" Shpk gje e cila do te arrihet nepermjet rezervave e fitimeve te pashperndara, gjendje me date 31.12.2006.
- Caktimin e z.Lavdimir Fusha, anetar i Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar, me Nr. Licence 97, dt.10.01.2001, per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me rezervat e fitimet e pashperndara, gjendje te dates 31.12.2006.
- Depozitimin e ketij vendimi prane zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Ky vendim eshte depozituar prane Zyres se Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 34084/11, date 25.07.2007 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.



Ne veshtrim te rendit te dites, Ortaku i Vetem i kesaj Shoqerise, pasi u njoh me Raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar te dates 08.07.2007 per Vleresimin e Kontributeve ne Natyre dhe Rezervave e Fitimeve te Pashperndara per Zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, gjendje e dates 31.12.2006, i pergatitur nga Eksperti Kontabel i Autorizuar Z.Lavdimir FUSHA, veren se ky raport eshte i drejte, ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe per keto arsye duhet miratuar.

Per keto arsye, Ortaku i Vetem i Shoqerise, pas shqyrtimit te rendit te dites;

VENDOSI

- Miratimin e Raportit te Ekspertit per vleresimin e kontributeve ne natyre dhe rezervave e fitimeve te pashperndara per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise te dates 08.07.2007, te pergatitur nga Z.Lavdimir Fusha, Ekspert Kontabel i Autorizuar.
- Zmadhimin e kapitalit themeltar te nenshkruar te kesaj shoqerie nga 100 000 (njqind mije) Leke ne **4 600 000 (kater milion e gjashteqind mije) Leke.**
- Numri i kuotave (pjeseve) te kapitalit, mbetet i pandryshueshem dhe rritet vetem vlere nominale e tyre.
- Vlere e çdo kuote (pjese) kapitali kalon nga 1000 (njemije) Leke ne 46 000 (dyzet e gjashte mije) Leke.
- Ortaku i Vetem i shoqerise do te jete zoterues i 100% te kuotave te kapitalit themeltar i cili do te perbehet nga 100 (njqind) kuota (pjese) kapitali.
- Depozitimimin e ketij vendimi prane zyres se Regjistrimit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "DENISA" SHPK

Mimoza ÇOBO

Mimoza Çobo

DENISA
EKSPORT
TIRANE

Mimoza Çobo

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 354/Rep.

Nr. 1286/Kol.



VERTETIM NENSHKRIMI



Sot ne daten 12 Korrik 2007 (dymije e shtate), ditën e enjte, une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane, me Seli ne Rrugen “ Sami Frasheri” vertetova firmen e vene ne Vendimin numer 2 te dates 09.07.2007, te Ortakes se Veteme te Shoqerise “ DENISA”SHPK te :

- 1- Mimoza Coba, e bija e Petritit, lindur ne Corovode me 25 Korrik 1963, banuese ne Tirane, madhore dhe me zotesi te plote juridike, mbajtese e pasaportes me numer Z 1685248.

Une noteri pasi e gjeta conform nenit 39 te Ligjes 7929 date 1 Qershor 1994 “ Per Noterine” e vertetova si me poshte.



NOTER
Eriketa Kokoli